



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 184 Prot

Tiranë, më 07.12. 2010

VENDIM Nr. 123, dt. 07.12.2010

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 07.12.2010, mbasi shqyrtoi "Kërkesën për miratim sondazhi arkeologjik në sheshin e ndërtimit "Godinë banimi 1,4,6,7 kate +garazh (nën tokë), kati përdhe dyqane", në adresën Lagjja Nr.6, Rruga "Hysen Myshketa", Durrës (Subjekti "FAKLE" sh.p.k),

VENDOSI:

- I. Miratimin e raportit të sondazhit arkeologjik të paraqitur nga ASHA për sheshin e ndërtimit të subjektit "FAKLE" sh.p.k, në adresën Lagjja Nr.6, Rruga "Hysen Myshketa", Durrës, me kushtin e kryerjes së një sondazhi shtesë deri në thellësinë e supozuar të shtresës kulturore.
- II. Pas verifikimit nga grupi i punës i KKA të këtij sondazhi shtesë, të lejohet fillimi i punimeve në sheshin e ndërtimit, të subjektit "FAKLE" sh.p.k. zona arkeologjike "B", Durrës.
- III. Të realizohet mbikëqyrja arkeologjike gjatë procesit të gërmimit të themeleve, bazuar në kontratën dypalëshe midis "FAKLE" sh.p.k. dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
- IV. Mbikëqyrja arkeologjike do të kryhet nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
FERDINAND XHAFERAJ
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
ROLAND OLLI

Konceptoi: M. Mcini
Konfirmoi: S. Lela



AGJENCIA E
SHËRBIMIT
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al